



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE BERAT

Nr. 1976 Prot.

Berat më, 17 /07 /2026

Lënda: Kërkesë për shpallje publike (të vendimeve për shpalljen debitor)

Drejtuar : DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
DEPARTAMENTIT TË ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT
SEKTORIT TË MONITORIMIT TË BORXHIT

Drejtuar : DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: "Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjja; Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1, Qendra;
"Pajtoni Bussines Center", kati 5. "

Bazuar në Nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe pikës 4 të Nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015, date 30.04.2015 "Kodit të Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" : " ...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe...";

Kërkojmë shpalljen publike në faqen zyrtare të vendimeve administrative për shpalljen debitor ndaj :

Operatorit ekonomik: "Kantina e Pijeve Skrapar", Nipt: K89205401H
Vendimi Nr. 39 datë 14.07.2026, në shumën totale (detyrim+penalitet) 1,311,348 Lekë
Vendimi Nr. 40 datë 14.07.2026, në shumën totale (detyrim+penalitet) 19,160 Lekë

Kjo kërkesë bëhet për faktin se opearatori nuk ka marrë njoftim në adresën e deklaruar dhe për vazhdimin e proçedurave të tjera ligjore është e nevojshme shpallja publike dhe data e shpalljes publike.
(Bashkëlidhur vendimet Nr.39,40 datë 14.07.2026 të Degës Doganore Berat.)

Ju falenderojmë për bashkëpunimin !

KRYETAR I DEGËS DOGANORE BERAT



Adresa: Ish Kombinati i Tekstileve, Berat

www.dogana.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE BERAT

Nr. 1943/2 prot.

Berat, më 14.07.2026

NJOFTIM VENDIMI

Subjekti: Kantina e Pijeve Skrapar, Nipt: K89205401H , Adresë : "Çorovodë, Skrapar"

Në zbatim të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr. 61/2012 "Per Akcizat ne Republikën e Shqipërisë". i ndryshuar;

Ju njoftojmë se:

Në vijim të verifikimeve të kryera nga autoritetet doganor është konstatuar:

Kundërvajtje administrative e akcizës


Për këto arsye:

Ju me Vendimin Nr. 39 , datë 14.07.2026 (bashkëngjitur) jeni shpallur debitor për:

• Detyrim akcize :	327,837	Lekë
• Penalitet :	983,511	Lekë
Total :	1,311,348	Lekë

Sa më sipër kërkohet paraqitja juaj pranë Degës Doganore brënda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për ekzekutimin vullnetar të vendimit të sipërcituar, në të kundërt Administrata Doganore do të ndërmarrë procedurat ligjore për rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara.

KRYETARI I DEGËS DOGANORE BERAT



Një kopje e kësaj letre është dorëzuar më datë _____ pranë Qendrës së Shoqërisë dhe agjentit doganor të përmendur këtu më sipër.

Firma e marrësit (ose në rastin e personit juridik e përfaqësuesit)	Marrës nuk gjendet Shkresa e njoftimit dorzuar:	Marrësi/personat e tjerë të përcaktuar nga ligji refuzojnë të nënshkruajnë.
	Firma e (Shënoni lidhjen e këtij personi me marrësin)	Nëpunësi që bën njoftimin/dëshmitari Nëpunësi që bën njoftimin/dëshmitari

Adresa: "Ish Kombinati i Tekstileve, Berat"

www.dogana.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE BERAT

Nr. 1943/1 prot.

Berat, më 7.07.2026

VENDIM NR.39

Sot më datë 14.07.2026 në rolin e Autoritetit Vendimmarrës të Degës Doganore Berat, pasi shqyrtova Proçesverbalin e konstatimit Nr. Serial 0024641 datë 12.05.2026 të mbajtur nga specialistet e Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës të Departamentit të Akcizës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave ndaj subjektit :
"Kantina e Pijeve Skrapar-Shpk" me NIPT K89205401H.

KONSTATOJ SE :

Në zbatim të Programi Kontrollit Nr.5566/1 Prot. datë 24.03.26, të miratuar nga Zv.Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, si dhe në bazë të neneve 20, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 61/2012 "Per Akcizat ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe neneve 57, 67 dhe 68 të V.K.M nr.612, të ndryshuar, Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës, inspektoi me datë 25.03.2026 ambientet e operatorit:

"Kantina e Pijeve Skrapar-Shpk" me NIPT K89205401H dhe adresë: "Corovode.Skrapar" .i pajisur me autorizim akcize Nr. AL2N150117008 si prodhues i produkteve të akcizes vere dhe raki, me magazine fiskale Nr. AL03431501191.

Grupi i kontrollit i përbërë nga Eriselda Vokshi (Pergjegjes SPA). Laureta Hibroj (Pergjegjes SPMLT) dhe Vasi Mani (Specialist SPA) në datën 25.03.2026, u paraqit pranë ambjenteve të magazinës fiskale, ku ushtroi kontroll/verifikim fizik të produkteve gjendje dhe në përfundim u mbajt proçesverbali i verifikimit fizik me nr.serial 0002118, datë 25.03.2026, i cili u firmos nga të dyja palet.

Periudha e kontrolluar: Nga kontrolli i fundit date 24.10.2024 deri në ditën e kontrollit date 25.03.2026.

Baza Ligjore: Ligji 61/2012 "Per Akcizat ne Republikën e Shqiperise" i ndryshuar, V.K.M-ja Nr.612, "Per Dispozitat Zbatuese" i ndryshuar, udhezimet dhe aktet e tjera nenligjore.

Grupi i kontrollit verifikoi regjistrimet në sistemin Asycuda dhe ekstremitetet ishin: Kodi 080610902000000, TWI_P, date 30.10.2024, sasia 35,049 kg.

Nga kontrolli i ushtruar ne magazinën fiskale të operatorit ekonomik rezultoi gjendja e pullave fiskale si më poshtë:

- Pulla fiskale vere 0.75 L11,168 cope
- Pulla fiskale vere 2 L7,100 cope
- Pulla fiskale vere 3 L5,900 cope
- Pulla fiskale vere 5 L957 cope
- Pulla fiskale rakie 0.2 L8,663 cope
- Pulla fiskale rakie 0.5 L4,819 cope
- Pulla fiskale rakie 0.7 L4,553 cope
- Pulla fiskale rakie 0.75 L14,233 cope
- Pulla fiskale rakie 1 L1,000 cope
- Pulla fiskale rakie 2 L3,400 cope
- Pulla fiskale rakie 5 L590 cope
- Pulla fiskale rakie 10 L718 cope
- Pulla fiskale pije alkoolike 0.75 L920 cope

Për përfllogaritjen e pullave fiskale u mbajt për bazë sasia gjendje me datë 24.10.2024, sasia totale e aktivizuar/blerë për të gjithë periudhën e kontrollit, krahasuar me sasinë e hedhur për konsum me DSHA, si edhe gjendjen fizike datë 25.03.2026, si është pasqyruar në tabelën përmbledhese të mëposhtme:

Lloji i pullave/ formati		Gjendje fillestare 24.10.2024		Hyrije 24.10.2024- 25.03.2026		Hedhur per konsum me DSHA 24.10.20 24- 25.03.2 026	Gjendje kontabel 25.03.20 26	Gjendje fizike 25.03.2026		Difere nca
		cope	litra	cope	litra			cope	litra	
		1	2	3	4			7	8	
Vere	0.75	6,560	4,920	5,000	3,750	0	47,672	11,168	8,376	-2,611
	2	2,926	5,852	5,000	10,000			7,100	14,200	
	3	1,000	3,000	5,000	15,000			5,900	17,700	
	5	1,030	5,150	0	0			957	4,785	
Total			18,922		28,750				45,061	
Rakie	0.2	4,000	800	5,000	1,000	0	38,552	8,663	1,733	-2,618
	0.5	640	320	5,000	2,500			4,819	2,410	

	0.7	1.712	1.198	5.000	3.500			4.553	3.187	
	0.75	10.04	7.530	5.000	3.750			14.233	10.675	
		0								
	1	1.000	1.000	0	0			1.000	1.000	
	2	1.407	2.814	2.000	4.000			3.400	6.800	
	5	592	2.960	0	0			590	2.950	
	10	718	7.180	0	0			718	7.180	
Total			23.802		14.750				35.934	
Pije.alkol	0.75	1.000	750	0	0	0	750	920	690	-60

Nga rakordimi i të dhënave të evidentuara gjatë kontrollit, krahasuar me regjistrat kontabël për periudhën objekt kontrolli, kanë rezultuar diferenca në pulla fiskale të konvertuara në 2,611 litra verë mangët, 2,618 litra raki mangët dhe 60 litra pije alkolike mangët, sasi mbi 2% të sasisë kontabël të llogaritur për periudhën objekt kontrolli, sipas përcaktimeve të nenit 23 të VKM 612 datë 05.09.2012, i ndryshuar.

Diferencat e konstatuara kategorizohen si kundërvajtje administrative në fushën e akcizës, sipas nenit 85 pika 1/a, për të cilën ka lindur detyrimi i akcizës sipas nenit 7 të ligjit të Ligji 61/2012 "Per Akcizat ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar.

Per shkeljen e kryer operatori penalizohet ne perputhje me nenin 90 pika 1 dhe 10 te Ligji 61/2012 "Per Akcizat ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar. Masa e gjobes percaktohet sa 3- fishi i detyrimeve te munguara qe duheshin paguar.

Gjithashtu, operatori duhet te paguaje detyrimin e munguar sipas percaktimit te nenit 85 pika 2, te Ligjit 61/2012 "Per Akcizat ne RSH", i ndryshuar.

1.Pulla vere manget:

Detyrimi i munguar 2,611 litra vere x 31.93 = 83,369 Lekë.

Penaliteti Leke 83,369 x 3 = 250.107 Lekë.

2.Pulla rakie manget

Detyrimi i munguar 2,618 litra raki x 212.84 x 40% = 222,886 Lekë.

Penaliteti Lekë 222.886 x 3 = 668,658 Leke

3.Pulla pije alkolike manget

Detyrimi i munguar 60 litra pije x 899.27 x 40% = 21.582 Lekë

Penaliteti 21,582 Leke x 3 = 64,746 Lekë

Nga Raporti Përfundimtar:

Lidhur me gjetjet e mesiperme, operatori eshte bere me dije me email-in e dates 04.05.2026, për të cilat ka paraqitur argumentat e tij si me poshte:

"Per sa i perket gjendjes fizike te pullave fiskale, ju bejme me dije se nuk kemi mundur te identifikojme sasinë që rezultan si diferencë. Pullat fiskale ruhen ne rëdo moment ne një vend te sigurt nga subjekti. Ju garantojme se diferencë e konstatuar, si me sipër, nuk është hedhur ne treg dhe nuk është perdorur. Per sa i perket diferencës se produkteve ne litra, kjo diferencë është krijuar si rezultat i fros gjate procesit te perpunimit. "

Lidhur me sa pretendohet nga operatori pullat fiskale jane te detyrueshme te qendrojne ne magazine per sa kohe nuk perdoren/hidhen ne qarkullim dhe duhet te ishin fizikisht ne momentin e inventarizimit nga grupi i kontrollit.

Sa më sipër, pretendimet nuk merren ne konsiderate pasi nuk jane te mbështetura ne ligj apo dispozita ligjore dhe rrjedhimisht nuk sjellin asnje prove apo informacion te ri, qe cenon konkluzionet e kontrollit dhe aktet perkatese te mbajtura nga grupi kontrollit.

Për këtë shkelje nga u mbajt procesverbali per verifikimin e kundërvajtjes administrative të akcizës nga specialistët e Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me Nr.serial 0024641 datë 12.05.2026.

Raporti Përfundimtar i Drejtorisë së Kontrolleve te Akcizës në DPD për Program Kontrollin Nr. 5566/3 prot.,date 14.05.2026 ka ardhur dhe është protokolluar në Degën Doganore Berat me hyrje Nr.1324 prot., datë 18.05.2026 në Degën Doganore Berat.

Me shkresë Nr. 1324/1 prot.,datë 19.05.2026 të Degës Doganore Berat është bërë : (Njoftimi i procesverbalit për verifikimin e kundervajtjes administrative Nr. Serial 0024641,00024642 date 12.05.2026, Procesverbali i kontrollit fizik Nr.Serial 0002118 date 25.03.2026 të njohur më parë nga subjekti, Program kontrolli Nr.5566/1 prot.,datë 24.03.2026 të njohur me parë nga subjekti, Raporti Përfundimtar i Drejtorisë se Kontrolleve te Akcizës në DPD për Program Kontrollin Nr. 5566/3 prot.,date 14.05.2026 ose Nr.1324 prot., date 18.05.2026 të Degës Doganore Berat.

Njoftimet në adresën e deklaruar të shkresës Nr. 1324/1 prot.,datë 19.05.2026 jane kthyer pas dy herë me shënimin: "Larguar". Njoftimet në adresën e deklaruar të shkresës Nr. 1324/1 prot.,datë 19.05.2026 jane kthyer pas dy herë me shënimin: "Larguar", me barkodet postare RR 838 455 140 AA, RR 830 250 349 AA.

Nga Dega Doganore u bë e mundur afishimi dhe shpalljes në sallën e pranimit të operatoreve ekonomik pranë Degës Doganore Berat me shkresë Nr.1500 prot.,datë 05.06.2026 të:

Njoftimit të shkresës Nr. 1324/1 prot. datë 19.05.2026 Degës Doganore Berat:(Për njoftimin e procesverbalit per verifikimin e kundervajtjes administrative Nr. Serial 0024641,00024642 date 12.05.2026.Procesverbalit te kontrollit fizik Nr.Serial 0002118 date 25.03.2026 të njohur më parë nga subjekti.Program kontrollit Nr.5566/1 prot.,datë 24.03.2026 të njohur me parë nga subjekti.Raporti Përfundimtari i Drejtorisë se

Kontrolleve te Akcizës në DPD për Program Kontrollin Nr. 5566/3 prot., date 14.05.2026 ose Nr.1324 prot., date 18.05.2026 te Degës Doganore Berat.

U kërkua me shkresën nr.1499 prot.,date 05.06.2026 të Degës Doganore Berat Bashkisë Skrapar publikimi në steden e njoftimeve të akteve te mesipërme dhe konfirmimi me njoftim nga Bashkia Skrapar i datës së publikimit. Nuk është kthyer përgjigje për datën e publikimit të shpalljes.

U bë Rikujtesë me shkresë nr.1661 prot.,date 17.06.2026 të Degës Doganore Berat Bashkisë Skrapar publikimi në steden e njoftimeve të akteve te mesipërme dhe konfirmimi me njoftim nga Bashkia Skrapar i datës së publikimit. Bashkia Skrapar ka marrë njoftim, është dorëzuar shkresa nëpërmjet konfirmës postare me RR 836 472 255 AA.

Nuk u kthye përgjigje dhe Dega Doganore Berat ka kërkuar informacion me e-mail me datë 26.06.2026 në adresën info@bashkiaskrapar.gov.al për konfirmimin e datës së shpalljes per aktet e mesiperme.Nuk u kthye përgjigje. U rikërkuar informacion me e-mail me datë 10.07.2026 në adresën info@bashkiaskrapar.gov.al për konfirmimin e datës së shpalljes per aktet e mesipërme.

Më datë 13.07.2026 nëpërmjet e-mail-it zyrtar nga adresa info@bashkiaskrapar.gov.al Bashkia Skrapar ka informuar Degën Doganore Berat dhe ka bashkëlidhur shkresën Nr.1774/1 prot., datë 10.07.2026 në të cilën informon se shpallja e kërkuar është afishur në këndin e njoftimeve të Bashkisë Skrapar në datën 19.06.2026.

Duke qënë se janë plotësuar afatet e shpalljes publike dhe subjekti konsiderohet i njoftuar sipas ligjit;

VENDOSA:

Subjekti: "Kantina e Pijeve Skrapar-Shpk" me NIPT **K89205401H** , të shpallet debitor si më poshtë :

- Detyrim akcize : 327,837 Lekë
- Penalitet : 983,511 Lekë
- Total : 1,311,348 Lekë
- Zyra e Financës dhe e Borxhit Doganor, të kryejë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse.
- Kundër këtij vendimi, subjekti "Kantina e Pijeve Skrapar-Shpk" me NIPT **K89205401H** lejohet të ushtrojë ankimim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja në dijeni e këtij vendimi pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave Tiranë, duke paguar shumën e përgjithshme të detyrimit te akcizes, si dhe të garantojë për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave shumën e përgjithshme të sanksioneve të aplikuara për shkeljen ne objekt, në zbatim te Nenin 105 te Ligjit Nr. 61/2015 "Pr Akcizat në Republikën e Shqipërisë".

KRYETARI I DEGËS DOGANORE BERAT



Adresa: Ish Kombinati i Tekstileve, Berat

www.dogana.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE BERAT

Nr. 1944/h prot.

Berat, më 14.07.2026

NJOFTIM VENDIMI

Subjekti: Kantina e Pijeve Skrapar, Nipt: K89205401H , Adresë : “Çorovodë, Skrapar”

Në zbatim të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 61/2012 “Per Akcizat ne Republikën e Shqipërisë”. i ndryshuar;

Ju njoftojmë se:

Në vijim të verifikimeve të kryera nga autoriteti doganor është konstatuar:

Kundërvajtje administrative e akcizës


Për këto arsye:

Ju me Vendimin Nr. 40 , datë 14.07.2026 (bashkëngjitur) jeni shpallur debitor për:

• Detyrim akcize :	4,790	Lekë
• Penalitet :	14,370	Lekë
Total :	19,160	Lekë

Sa më sipër kërkohet paraqitja juaj pranë Degës Doganore brënda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për ekzekutimin vullnetar të vendimit të sipërcituar, në të kundërt Administrata Doganore do të ndërmarrë procedurat ligjore për rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara.

KRYETARI I DEGËS DOGANORE BERAT



Një kopje e kësaj letre është dorëzuar më datë _____ pranë Qendrës së Shoqërisë dhe agjencit doganor të përmendur këtu më sipër.

Firma e marrësit (ose në rastin e personit juridik e përfaqësuesit)	Marrës nuk gjendet Shkresa e njoftimit dorzuar:	Marrësi/personat e tjerë të përcaktuar nga ligji refuzojnë të nënshkruajnë.
	Firma e _____	Nëpunësi që bën njoftimin/dëshmitari
	(Shënoni lidhjen e këtij personi me marrësin)	Nëpunësi që bën njoftimin/dëshmitari

Adresa: “Ish Kombinati i Tekstileve, Berat”

www.dogana.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE BERAT

Nr. 1944/prot.

Berat, më 7.07.2026

VENDIM NR.40

Sot më datë 14.07.2026 në rolin e Autoritetit Vendimmarrës të Degës Doganore Berat, pasi shqyrtova Proçesverbalin e konstatimit Nr. Serial 0024642 datë 12.05.2026 të mbajtur nga specialistet e Drejtorisë së Kontrollleve të Akcizës të Departamentit të Akcizës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave ndaj subjektit : "Kantina e Pijeve Skrapar-Shpk" me NIPT K89205401H.

KONSTATOJ SE :

Në zbatim të Program Kontrollit Nr.5566/I Prot. datë 24.03.26, të miratuar nga Zv.Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, si dhe në bazë të neneve 20, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 61/2012 "Per Akcizat ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar si dhe neneve 57, 67 dhe 68 të V.K.M nr.612, të ndryshuar, Drejtoria e Kontrollleve të Akcizës, inspektoi me datë 25.03.2026 ambientet e operatorit:

"Kantina e Pijeve Skrapar-Shpk" me NIPT K89205401H dhe adresë: "Corovode.Skrapar" .i pajisur me autorizim akcize Nr. AL2N150117008 si prodhues i produkteve të akcizes vere dhe raki, me magazine fiskale Nr. AL03431501191.

Grupi i kontrollit i përbërë nga Eriselda Vokshi (Pergjegjes SPA). Laureta Hibroj (Pergjegjes SPMLT) dhe Vasi Mani (Specialist SPA) në datën 25.03.2026, u paraqit pranë ambjenteve të magazinës fiskale, ku ushtroi kontroll/verifikim fizik të produkteve gjendje dhe në përfundim u mbajt proçesverbali i verifikimit fizik me nr.serial 0002118, datë 25.03.2026, i cili u firmos nga të dyja palet.

Periudha e kontrolluar: Nga kontrolli i fundit date 24.10.2024 deri në ditën e kontrollit date 25.03.2026.

Baza Ligjore: Ligji 61/2012 "Per Akcizat ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar. V.K.M-ja Nr.612, "Per Dispozitat Zbatuese" i ndryshuar, udhezimet dhe aktet e tjera nenligjore.

Nga inventarizimi i plotë i mallrave të akcizës (lëndë e parë, produkt i gatshëm, produkt i ndermjetëm), gjendje në magazinën fiskale të operatori rezultoi gjendja fizike si mëposhte:

•	Leng+ bersi rrushi.....	19,000 litra
•	Verene depozite inoksi.....	5,700 litra
•	Raki në depozita inoksi.....	8,121 litra
•	Pije alkolike rifuxho.....	6,600 litra
•	Distilat rrushi 40%.....	2,700 litra

Për rakordimin e produkteve u bazua në sasinë gjendje me datë 24.10.2024, sasine totale të prodhuar për të gjithë periudhën e kontrollit, krahasuar sasine e hedhur për konsum me DSHA, si edhe gjendjen fizike datë 25.03.2026, si është pasqyruar në tabelën përmbledhëse të mëposhtme:

<i>Produkte</i>	<i>Gjendje flwestare 24.10.2024</i>	<i>Hyrje 24.10.2024- 25.03.2026</i>	<i>Hedhur për konsum 24.10.2024- 25.03.2026</i>	<i>Gjendje kontabel 25.03.2026</i>	<i>Gjendje fizike 25.03.2026</i>	<i>Diferenca</i>
	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	<i>6 (5-6)</i>
Vere	5,850	0	0	5,850	5,700	-150
Raki	8,162	0	0	8,162	8,121	-41
Pije alko.	6,600	0	0	6,600	6,600	0

Nga rakordimi i të dhënave të mësipërme rezultuan diferencat prej 41 litra raki mangët, sasi nën 2% e lejuar, të cilat nuk përbëjnë kundërvajtje administrative, por i lihet detyrë operatorit të kryejë rregullimet në sistem me DSHA dalje me tip levizje 4- hedhje për konsum, me qëllim pagimin e detyrimit të akcizës dhe pasqyrimin e gjendjes reale për secilin produkt.

Gjithashtu, nga rakordimi i të dhënave, rezultuan diferenca në produktin vere në sasine 150 litra mangët, sasi mbi 2% të sasise kontabel të llogaritur për periudhën objekt kontrolli, sipas përcaktimeve të nenit 62 të VKM 612 datë 05.09.2012, i ndryshuar.

Diferencat e konstatuara kategorizohen si kundërvajtje administrative në fushën e akcizës, sipas nenit 85 pika 1/a, për të cilën ka lindur detyrimi i akcizës sipas përcaktimeve të nenit 7 të Ligji 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Për shkeljen e kryer, operatori ekonomik penalizohet në përputhje me nenin 90 pika 1 të Ligji 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për shkak se mangësitë e konstatuara tejkalojnë kufirin ligjor prej 2%. Masa e gjobes përcaktohet sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar.

Gjithashtu, operatori duhet të paguajë detyrimin e munguar sipas përcaktimit të nenit 85 pika 2, të Ligjit 61/2012 "Për Akcizat në RSH", i ndryshuar.

Vere mangët:

Detyrimi i munguar 150 litra vere x 31.93 = 4,790 Lekë

Penaliteti 4,790 Lekë x 3 = 14.370 Lekë

Nga Raporti Përfundimtar:

Lidhur me pretendimin se diferencat e konstatuara ne produktet vere dhe raki jane firo. ju sjellim ne vemendje se frot deklarohen nga operatori ne perputhje me aneksin 14 te VKM-se nr.612 dt. 05.09.2012 "Per Dispozitat Zbatuese te Ligjit per Akcizat", i ndryshuar.

Sa më sipër, pretendimet nuk u morren ne konsiderate pasi nuk janë të mbështetura në ligj apo dispozita ligjore dhe rrjedhimisht nuk sjellin asnje prove apo informacion te ri, qe cenon konkluzionet e kontrollit dhe aktet perkatese te mbajtura nga grupi kontrollit.

Për këtë shkelje nga u mbajt procesverbali per verifikimin e kundërvajtjes administrative të akcizes nga specialistët e Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me Nr.serial 0024642 datë 12.05.2026

Raporti Përfundimtar i Drejtorisë së Kontrolleve te Akcizës në DPD për Program Kontrollin Nr. 5566/3 prot.,date 14.05.2026 ka ardhur dhe është protokolluar në Degën Doganore Berat me hyrje Nr.1324 prot., datë 18.05.2026 në Degën Doganore Berat.

Me shkresë Nr. 1324/1 prot.,datë 19.05.2026 të Degës Doganore Berat është bërë : (Njoftimi i procesverbalit për verifikimin e kundervajtjes administrative Nr. Serial 0024641,00024642 date 12.05.2026, Procesverbali i kontrollit fizik Nr.Serial 0002118 date 25.03.2026 të njohur më parë nga subjekti, Program kontrolli Nr.5566/1 prot.,datë 24.03.2026 të njohur me parë nga subjekti, Raporti Përfundimtar i Drejtorisë se Kontrolleve te Akcizës në DPD për Program Kontrollin Nr. 5566/3 prot.,date 14.05.2026 ose Nr.1324 prot., date 18.05.2026 të Degës Doganore Berat.

Njoftimet në adresën e deklaruar të shkresës Nr. 1324/1 prot.,datë 19.05.2026 jane kthyer pas dy herë me shënimin: "Larguar", me barkodet postare RR 838 455 140 AA, RR 830 250 349 AA.

Nga Dega Doganore u bë e mundur afishimi dhe shpalljes në sallën e pranimi të operatoreve ekonomik pranë Degës Doganore Berat me shkresë Nr.1500 prot.,datë 05.06.2026 të:

Njoftimit të shkresës Nr. 1324/1 prot. datë 19.05.2026 Degës Doganore Berat.(Për njoftimin e procesverbalit per verifikimin e kundervajtjes administrative Nr. Serial 0024641.00024642 date 12.05.2026.Procesverbalit te kontrollit fizik Nr.Serial 0002118 date 25.03.2026 të njohur më parë nga subjekti.Program kontrollit Nr.5566/1 prot.,datë 24.03.2026 të njohur me parë nga subjekti,Raporti Përfundimtari i Drejtorisë se Kontrolleve te Akcizës në DPD për Program Kontrollin Nr. 5566/3 prot.,date 14.05.2026 ose Nr.1324 prot., date 18.05.2026 te Deges Doganore Berat.

U kërkua me shkresën nr.1499 prot.,date 05.06.2026 të Degës Doganore Berat Bashkisë Skrapar publikimi në stedën e njoftimeve të akteve te mesipërme dhe konfirmimi me njoftim nga Bashkia Skrapar i datës së publikimit. Nuk është kthyer përgjigje për datën e publikimit të shpalljes.

U bë Rikujtesë me shkresë nr.1661 prot.,date 17.06.2026 të Degës Doganore Berat Bashkisë Skrapar publikimi në stedën e njoftimeve të akteve te mesipërme dhe konfirmimi me njoftim nga Bashkia Skrapar i datës së publikimit. Bashkia Skrapar ka marrë njoftim, është dorëzuar shkresa nëpërmjet konfirmës postare me RR 836 472 255 A.A.

Nuk u kthye përgjigje dhe Dega Doganore Berat ka kërkuar informacion me e-mail me datë 26.06.2026 në adresën info@bashkiaskrapar.gov.al për konfirmimin e datës së shpalljes per aktet e mesiperme.Nuk u kthye përgjigje. U rikërkuar informacion me e-mail me datë 10.07.2026 në adresën info@bashkiaskrapar.gov.al për konfirmimin e datës së shpalljes per aktet e mësipërme.

Më datë 13.07.2026 nëpërmjet e-mail-it zyrtar nga adresa info@bashkiaskrapar.gov.al Bashkia Skrapar ka informuar Degën Doganore Berat dhe ka bashkëlidhur shkresën Nr.1774/I prot., datë 10.07.2026 në të cilën informen se shpallja e kërkuar është afishur në këndin e njoftimeve të Bashkisë Skrapar në datën 19.06.2026.


Duke qënë se janë plotësuar afatet e shpalljes publike dhe subjekti konsiderohet i njoftuar sipas ligjit;

VENDOSA:

Subjekti: "Kantina e Pijeve Skrapar-Shpk" me NIPT K89205401H , të shpallet debitor si më poshtë :

- Detyrim akcize : 4,790 Lekë
- Penalitet : 14,370 Lekë
- Total : 19,160 Lekë
- Zyra e Financës dhe e Borxhit Doganor, të kryejë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse.
- Kundër këtij vendimi, subjekti "Kantina e Pijeve Skrapar-Shpk" me NIPT K89205401H lejohet të ushtrojë ankimim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja në dijeni e këtij vendimi pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave Tiranë, duke paguar shumën e përgjithshme të detyrimit te akcizes, si dhe të garantojë për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave shumën e përgjithshme të sanksioneve të aplikuara për shkeljen ne objekt, në zbatim te Nenin 105 te Ligjit Nr. 61/2015 "Per Akcizat në Republikën e Shqipërisë".

KRYETARI I DEGËS DOGANORE BERAT



Adresa: "Ish Kombinati i Tekstileve, Berat"

www.dogana.gov.al